

Vendim nr. 221, datë 26.06.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sandër Beci,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 26.06.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (Sh) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: SHABAN ZHUKA

OBJEKTI: Anulimi i ligjit nr. 109, datë 20.12.2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut”, pasi në këtë ligj nuk përfshihen edhe punonjësit që aksidentohen për vdekje në punë, të cilëve Instituti i Sigurimeve Shëndetësore ua njeh aksidentimin në punë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 33, 35, 42, 49, 57, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 2, 20, 21, 27, 28, 31, 32, 33, 34, 38, 39, pikat 1, shkronjat “a” dhe “b”, 3 dhe 4, 42, 43 e vijues, 71, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, 71/c, pikat 1, 2 dhe 3, 72, 76, pikat 1 dhe 6, 81 dhe 86, pika 3, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është i ati i të ndjerit G.Zh., i cili ka qenë punonjës i Policisë së Shtetit, me detyrë “përgjegjës turni” në pikën e kalimit kufitar të Hanit të Hotit, Shkodër. Në datën 16.06.2023 ky i fundit ka humbur jetën për shkak të një aksidenti të ndodhur në aksin rrugor Balldre-Lezhë, duke u kthyer nga qyteti i Shkodrës për në Tiranë ku ishte me banim. I ndjeri ka lënë pas bashkëshorten dhe dy fëmijë.

2. Kërkuesi u është drejtuar disa institucioneve shtetërore, duke kërkuar trajtimin e fëmijëve të të birit si familjarë të punonjësit të policisë, të aksidentuar për shkak të detyrës. Më pas, në datën 16.02.2025, ai i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 82/2024, datë 26.07.2024 “Për Policinë e Shtetit”, në pjesën që nuk përfshinte shpërblimin e fëmijëve deri në moshën 18 vjeç të punonjësve të Policisë së Shtetit të aksidentuar në punë, të cilëve Instituti i Sigurimeve Shëndetësore (*ISSH*) u njihte aksidentimin në punë.

3. Me vendimin nr. 94, datë 15.04.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi, në cilësinë e të atit të të ndjerit, ish-polic, nuk justifikonte interesin e tij, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, e 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, ndaj nuk legjitimohej *ratione personae* në paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

4. Në datën 22.04.2026 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar tashmë shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 109, datë 20.12.2018 “Për statusin e dëshmorit të atdheut” (*ligji nr. 109/2018*) në pjesën që nuk parashikon shpalljen dëshmorë të atdheut të policëve të aksidentuar në të njëjtat rrethana si ato të djalit të tij, G.Zh., të cilëve ISSH-ja u ka njohur aksidentimin në punë.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ligji nr. 109/2018, në pjesën që nuk përmban parashikime konkrete për detyrimin e organeve shtetërore për të trajtuar si dëshmorë të atdheut punonjësit e policisë të aksidentuar gjatë kthimit të tyre në banesë pas përfundimit të punës, është jokushtetues, ndaj duhet të shfuqizohet. Sipas tij, aksidenti i të birit është rrjedhojë e mosmarrjes së masave nga Drejtoria e Kufirit Shkodër për sigurimin e

transportit të punonjësve të saj. Ditën e aksidentit i biri kishte lënë detyrën pas 20 orëve punë dhe nëse punëdhënësi do t'i kishte siguruar transport, aksidenti nuk do të kishte ndodhur. Një situatë e tillë ka vënë në vështirësi financiare fëmijët dhe bashkëshorten e të birit të aksidentuar. Pensioni i akorduar fëmijëve është minimal, ndërsa bashkëshortja e të ndjerit është e papunë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

6. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Gjykata ka theksuar se kur objekt i ankimit kushtetues individual është një ligj ose një akt normativ, kërkuuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 1, datë 14.01.2026; nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

8. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative. Në këtë këndvështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Mospërmblidhja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e çështjes në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera.

9. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi është i ati i ish-punonjësit të Policisë së Shtetit, të ndjerit G.Zh., i cili ka humbur jetën në një aksident rrugor gjatë kthimit nga puna, duke lënë pas bashkëshorten e tij dhe dy fëmijë të mitur. Për këtë shkak, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr. 109/2018, në pjesën që nuk parashikon dhënien e statusit të dëshmorëve të atdheut punonjësve të policisë të aksidentuar gjatë kthimit në banesat e tyre pas përfundimit të ditës së punës. Po sipas kërkuesit, një situatë e tillë ka vënë në vështirësi financiare fëmijët e bashkëshorten e të birit të aksidentuar.

10. Në analizë të ligjit nr. 109/2018, Kolegji vëren se në nenin 5 ai ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe shteruese kriteret e rrethanat në të cilat një person mund të shpallet ose t'i njihet statusi "Dëshmor i atdheut". Ato lidhen me ekzistencën e situatave specifike, të cilat kanë të bëjnë me humbjen e jetës në mbrojtje të lirisë, pavarësisë kombëtare, interesit publik, rendit kushtetues, sigurisë kombëtare, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ose në rrethana të tjera të veçanta. Po kështu, sipas nenit 18, pika 1, të këtij ligji, familjet e dëshmorëve të atdheut përfitojnë shpërblim financiar mujor, kriteret dhe masa e të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

11. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për shpërblim financiar mujor të familjarëve të dëshmorit nuk është një e drejtë themelore e parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ose konventat ndërkombëtare dhe as një e drejtë që derivon nga ligje që janë zbatim i të drejtave themelore të qytetarëve. Ajo nuk rrjedh as nga e drejta e sigurimeve shoqërore dhe, rrjedhimisht, kushtet e dhënies e të ndryshimit të saj nuk mund të barazohen me të drejtën e përfitimit të pensioneve si një e drejtë themelore, e parashikuar në nenin 52 të Kushtetutës. Shpërblimi financiar mujor i familjarëve të dëshmorit ka karakter simbolik dhe është pjesë e nderimit dhe e respektit që shteti bën për veprën e dëshmorit, prandaj masa e tij, si dhe rrethi i subjekteve që përfitojnë vlerësohen nga ligjvënësi (*shih vendimin nr. 41, datë 16.11.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence, në rastin konkret, Kolegji vë në dukje se e drejta për të përfituar shpërblim financiar nga familja e dëshmorit nuk gëzon mbrojtje kushtetuese, por vetëm ligjore, ndërsa rrethanat e parashtruara nga kërkuesi, konkretisht humbja e jetës së punonjësit të policisë, si rrjedhojë e aksidentimit pas përfundimit të ditës së punës, nuk parashikohet shprehimisht në kategoritë e përcaktuara nga ligji nr. 109/2018 për përfitimin e statusit të dëshmorit të atdheut. Në këtë situatë, duke pasur parasysh edhe natyrën subsidiare të gjykimit kushtetues, Kolegji thekson se Gjykata nuk mund të zëvendësojë organet

e tjera të pushtetit publik në ushtrimin e kompetencave të tyre dhe as të shprehet përpara se vetë këto organe t'i japin kuptim normës ligjore të zbatueshme në një rast konkret të caktuar.

13. Kolegji vë në dukje gjithashtu se ndonëse formalisht kërkuesi ka kundërshtuar kushtetutshmërinë e ligjit nr. 109/2018, në thelb ai ka parashtruar të njëjtat pretendime dhe argumente që kanë qenë objekt shqyrtimi edhe në ankimin e mëparshëm kushtetues individual për shfuqizimin e ligjit nr. 82/2024, duke kërkuar njohjen e një trajtimi të posaçëm për familjarët e punonjësit të policisë që ka humbur jetën në rrethanat e përshkruara prej tij, pa përcaktuar të drejtën kushtetuese të cenuar për këtë shkak dhe pa iu drejtuar më parë organeve të tjera të pushtetit publik.

14. Për sa më sipër, në kushtet kur kërkuesi nuk ka arritur të përcaktojë se gëzon një të drejtë kushtetuese, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, dhe përmes ankimit kushtetues individual kërkon mbrojtjen e të drejtave të personave të tjerë, Kolegji vlerëson se ai nuk legjitimohet *ratione personae* në ankimin kushtetues individual, pasi nuk justifikon interesin e tij në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës dhe nenit 49, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “a” dhe “c”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.